

Përmbledhje



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

SUBJEKT I MONITORUAR: OLS DADO , PROKUROR, PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE
DATË 01/11/2022 PRANË KPK:**

-  Kriteri i pasurisë: Raporti nga ILDKPKI bazuar me nenin 33 të ligjit 84/2016 u citua si deklaram i saktë në përputhje me ligjin, burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, nuk rezultoi fshehje apo deklaram i rremë dhe jo konflikt interesi.
-  Kriteri i kontrollit të figurës: Raporti i ardhur nga DSIK në bazë të nenit 39 të ligjit 84/2016 deklaroi që për subjektin e rivlerësimit nuk ka informacion për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit dhe konfirmonte përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës
-  Mbi rivlerësimin e aftësive profesionale: Lidhur me aftësitë profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konfirmon se ndaj subjektit nuk janë marrë masa disiplinore. Subjekti i rivlerësimit vlerësohet për aftësi të mira në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, arsyetim i drejtë dhe me logjikë të mirë



Subjekti i rivlerësimit Z. Ols Dado përballë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Më datë 01 nëntor 2022, në KPK, u zhvillua seanca dëgjimore e z. Ols Dado, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktualisht i komanduar në pozicionin si ndihmës magjistrat në Prokurorinë e Përgjithshme. Trupi gjykues përbëhej nga Valbona Sanxhaktari (Kryesuese), Genta Tafa Bungo (Relatore) dhe Lulzim Hamitaj (Anëtar). Si vëzhgues ndërkombëtar ishte e pranishme znj. Marie Tuma e cila gjatë seancës dëgjimore mbajti qëndrim korrekt në përputhje me etikën por nuk drejtoi pyetje ndaj subjektit.

Proçesi i rivlerësimit për subjektin ishte realizuar mbi bazën e kriterit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi të aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të paraqitej pa praninë e një përfaqësuesi ligjor, kjo si zgjedhje e tij dhe jo si cënim i kësaj të drejte bazuar në nenin 35-38 të KPrA.

Subjekti i rivlerësimit nuk ngriti kërkesa paraprake lidhur me njëanshmërinë gjatë procesit apo konflikt interesi të trupës së rivlerësimit.

Kriteti i pasurisë: Raporti nga ILDKPKI bazuar me nenin 33 të ligjit 84/2016 u citua si deklaram i saktë në përputhje me ligjin, burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, nuk rezultoi fshehje apo deklaram i rremë dhe jo konflikt interesi. Raporti u konsiderua i plotë për sa i përket pasurive të paluajtshme, automjetit, depozitës së kursimit dhe burimeve financiare të derdhura nga prindërit e tij, paga e tij si prokuror dhe “shitje pjesë apartamenti”.

Kontrolli i figurës: Raporti i ardhur nga DSIK në bazë të nenit 39 të ligjit 84/2016 deklaroi që për subjektin e rivlerësimit nuk ka informacion për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit dhe konfirmonte përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

Kriteri i aftësive profesionale: Lidhur me aftësitë profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konfirmon se ndaj subjektit nuk janë marrë masa disiplinore. Subjekti i rivlerësimit vlerësohet për aftësi të mira në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, arsyetim i drejtë dhe me logjikë të mirë.

Denoncimet: Pavarësisht se seanca është publike trupa gjykuese nuk relatoi objektin e ankesave të ardhura në drejtim të subjektit por u pohua që ishin bërë 3 denoncime ku për 2 prej tyre i ishte kaluar barra e provës subjektit. Ndaj subjektit z. Dado ka disa materiale hetimore të regjistruara në prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë. Më konkretisht janë 4 kallëzime penale të pafilluara për të cilat nuk u dhanë sqarime të mëtejshme.

Subjektit iu dha mundësia për tu dëgjuar por ai nuk parashtroi fakte të reja përtej atyre që i ishin kërkuar gjatë kalimit të barrës së provës bazuar në nenin 49 pika 1/b të ligjit 49/2016. Z. Dado kishte marrë në dorëzim materialet e dosjes dhe i është lënë afat 7 ditë kohë për t'u njohur me të sipas nenit 45-47 të KPrA.

Z.Ols Dado Konfirmohet në detyrë pas seancës për shpalljen e vendimit ditën e sotme datë 03.11.2022.